

LIGJ

Nr.7627, datë 21.10.1992

PER SHERBIMIN ZOOTEKNIK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991
"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit
të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I

ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE DETYRAT E SHERBIMIT ZOOTEKNIK

Neni 1

Shërbimi zooteknik organizohet në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai përbëhet nga shërbimi zooteknik dhe inspektoriati i kontrollit ligjor për zootekninë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, në organet lokale të pushtetit, institucionet teknike e shkencore të zooteknisë dhe shërbimit zooteknik pranë prodhuesve.

Neni 2

Shërbimi zooteknik organizohet e drejtohet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe ka për detyrë:

- a) Të zbatojë legjislacionin për zootekninë;
- b) Të përcaktojë përparësitë dhe të nxisë zhvillimin e blegtorisë sipas llojeve, racave e zonave në raport me stadin e zhvillimit të vendit;
- c) Të përcaktojë e drejtojë masat për ruajtjen, shtimin dhe zhvillimin e fondit gjenetik të kafshëve, shpendëve e zookulturave;
- ç) Të përpunojë e përhapë teknologjitë bashkëkohore për mbarështimin dhe të ushqyerit e kafshëve, shpendëve e zookulturave;
- d) të përcaktojë drejtimet e kërkimeve shkencore në fushën e zooteknisë;
- dh) Të organizojë e drejtojë punën për kualifikimin e zooteknikëve e të prodhuesve, të nxisë e përhapë arritjet më të mira në blegtori dhe të mbështetë veprimtarinë e shoqatave të prirësve të kafshëve, shpendëve e zookulturave.

KREU II

KUPTIMI DHE PERMBAJTJA E FONDIT GJENETIK

Neni 3

Fondi gjenetik përfshin tërësinë e individëve e të grupeve të kafshëve e shpendëve shtëpiakë dhe të zookulturave, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Fondi gjenetik në të gjitha format e pronësisë mbrohet nga shteti.

Neni 5

Për qëllime të ruajtjes, zhvillimit e përdorimit të fondit gjenetik të racave të kultivuara dhe atyre autoktone, me vendim të Këshillit të Ministrave, ngrihen koleksione, qendra racore dhe banka gjenetike.

KREU III

PERMIRËSIMI RACOR I BLEGTORISE

Neni 6

Përmirësimi racor i blegtorisë në territorin e Republikës së Shqipërisë drejtohet nga drejtoria e blegtorisë në Ministrinë e Bujqësisë e Ushqimit, Instituti i Kërkimeve Zooteknike, stacionet zooteknike rajonale, specialistët e punës racore në rrethe dhe stacionet e punës racore në fshatra.

Neni 7

Kafshë, shpendë dhe zookultura të cilësuar të racës quhen individët dhe grupet që përmbushin cilësitë e racës dhe regjistrohen në një libër shtetëror të racës.

Libri shtetëror i racës mbahet nga Instituti i Kërkimeve Zooteknike dhe specialistët e punës racore në rrethe.

Neni 8

Kafshët, shpendët dhe zookulturat të cilësuar të racës matrikulohen. Në to ushtrohet kontrolli i prodhimtarisë dhe mbahet dokumentacioni i miratuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, kur e sheh të nevojshme, organizon matrikulimin edhe në kafshë të prodhimit që nuk janë cilësuar të racës.

Neni 9

Inseminimi i kafshëve kryhet nga stacionet e punës racore me material biologjik dhe reproduktorë të miratuar nga shërbimi zooteknik. Specialistët e punës racore në rreth kryejnë kastrimin e damazëve të pamiratuar si reproduktorë.

Neni 10

Në kafshët e cilësuara të racës ndalohet inseminimi me material biologjik e reproduktorë të racave të tjera. Përfshihet nga ky nen bëjnë kryqëzimet që kryhen për qëllime studimi me leje të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 11

Therja dhe ndryshimi i pronësisë së kafshëve të cilësuara të racës bëhet nën mbikëqyrjen e shërbimit zooteknik të rrethit, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 12

Për harmonizimin e punës racore në shkallë vendi krijohet komisioni qendror i përmirësimit racor pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit me këto detyra:

- a) Cakton kriteret për regjistrimin e kafshëve, të shpendëve dhe të zookulturave në librat shtetërorë të racës;
- b) Ateston racat që krijohen në vend;
- c) Miraton futjen në Republikën e Shqipërisë të kafshëve, shpendëve dhe zookulturave të racave të reja ose të materialit të tyre biologjik nga shtete të tjera dhe eksportimin nga Republika e Shqipërisë të kafshëve, shpendëve e zookulturave të cilësuara të racës, ose të materialit të tyre biologjik.

Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit emëron kryetarin dhe miraton përbërjen dhe rregulloren e funksionimit të këtij komisioni.

KREU IV

BAZA USHQIMORE, TE USHQYERIT DHE NDERTIMET PER BLEGTORINE

Neni 13

Ushqimet e industrializuara për blegtorinë përballohen e përdoren në bazë të standarteve shtetërore. Ato duhet të sigurojnë funksionimin normal të proceseve fiziologjike në kafshë, shpendë e zookultura dhe të garantojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

Neni 14

Importimi dhe eksportimi i lëndëve të para dhe të ushqimeve të plota për blegtorinë bëhet nën kontrollin e shërbimit zooteknik e në bashkëpunim me atë veterinar.

Neni 15

Ndërtimet për blegtorinë ose ato që lidhen me të, bëhen në pajtim me kërkesat zoohigjenike dhe garantojnë mbrojtjen e mjedisit.

KREU V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 16

Shteti mbështet me mjete financiare zhvillimin e blegtorisë, punën për ruajtjen e zhvillimin e fondit gjenetik dhe përmirësimin racor në kafshë, shpendë e zookultura.

Objekti, kuotat dhe koha e financimit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 14 e 15 të këtij ligji, kur nuk formon vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 1000 deri 5000 lekë nga inspektorët e shërbimit zooteknik të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit e të rretheve.

Neni 18

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose njoftimit të tij, te kryeinspektori i shërbimit zooteknik në Ministrinë e Bujqësisë e Ushqimit, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.341, datë 4.11.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.